

لاهور، پاکستان
BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-1
S66

PERSERI MENGUEZ

Vehbi
Skënderi

poezi

826-1

566

VEHBI SKËNDERI

~~826~~

PËRSËRI MËNGJEZ

Poezi

BIBLIOTEKA E SHQITIT
GJIRONASTER

№ INV 61579

34986

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

PËRSËRI NË LIQENIN E VAUT TË DEJES

Në qoftë se doni të dini si kthehet
kaltërsia në grimca drite,
dhe grimca e dritës në kaltërsi,
vështroni këtë liqen!

Në qoftë se doni të dini
se si mund të lindin
nga pika e djersës,
dete, male e monumente,
ashtu si lindin nga pika e bërthamës
pisha e pyje,
vështroni këtë liqen!

Në qoftë se doni të dini
se sa të kthjellët e të bukur
janë sytë e Komunizmit,
vështroni këtë liqen!

P A R T I A

S'e fshehim. Ne hynim në këtë buzëshekulli
të drojtur e të belbët si fëmijë.

Çapiteshim

e s'dinim se ku shkonim.

Me vite e shekuj prisnim ditën e madhe,

me syrin në shënjestër

e duke pritur vdisnim.

Partia qysh ditën që lindi thirri:

— Mjaft pritmë!

S'e fshehim. Ne hymë në këtë buzëshekulli
të qetë si shkëmbijtë dhe të shqetësuar si erërat.

Dyshonim për çdo gjë e për çdo gjë besonim.

Endnim ditë e natë, me fijet e ëndrrave,

më me durim se Penelopa e legjendës

dhe pyesnim plot ankth:

— Kur do të ngrihet prapë nga shtrati Gjergj Elez
Alia?

Partia qysh ditën që lindi dha sihariqin:

— Çdonjëri nga ne është një Gjergj Elez Ali,
që mund t'i presë kokën çdo përbindshi.

S'e fshehim. Ne hymë në këtë buzëshekulli
naivë si fëmijë dhe karasëzë si pleqtë.

Besimin tonë e kishim mbjellë

siç mbjell veriu polenin

në baltë e në hapësirë:

besonim tokën, detin, qiellin,

besonim djajtë, ëngjëjt, shtojzavallet,

që zhdokeshin (siç tregonin) sa ndjenin flladin e
mëngjezeve,

por nuk besonim në dashurinë e njerëzve të një ideali.

Partia qysh ditën që lindi lëshoi kushtrimin:

— Me këtë dashuri do të pushtojmë çdo majë mali! —

S'e fshehim. Ne hynim në këtë buzëshekulli
me thesin e mjerimit përmbi shpinë
dhe pushkën e Gjolekës përmbi supe.
Por, ndërsa çanin tutje
mes tufaneve,
shushunjat e babzitura këllgjinin skutave
vezët e nepërkave,
ndërthurnin të papritura
e deshën të shartonin prapë nëpër kërcejt e halleve
të popullit
arrën e hidhur të robërisë së gjatë.

Partia qysh ditën që lindi thirri qartë:
— Të djegim me barut çdo gram e çdo ferrë të keqe
që mos t'ia zenë ferrat diellin kurrë
kësaj toke me legjenda tremijëvjeçare.
tremijëvjeçe.

1971

Dikush mendon me vete:

«Jam i imunizuar dhe i papushtueshëm».

Por ju e dini mirë,

se një kala të fortë me mure qiklopikë,
që nuk e kishin shëmbur topat e flakëhedhëset,
që nuk e kishin ngrënë dot epidemia dhe uria,
që nuk e kishin tundur sa e sa tërmete,

e shembën

ca pikëza qorre,
që futeshin në trupin e saj,
(pa u vënë re)
nga disa vrima e plasa

të fshehta.

Dikush mendon se mbaroi lufta

dhe mund të mbështetet i qetë
në cohën e poltronave,
për të ndjekur programet televizive.

Jo, jo!

Ata që na merrnin në shenjë
me breshërima të plumbta,
sot na qëllojnë me vesëra tingujsh.
Dhe tingujt shkojnë më thellë

se plumbat dhe ciflat e

predhave.

Tingujt vrasin më shumë!

Gusht 1972

THËNGJIJ TË KUÇ

*Kovaçit të të gjithë hidrocentraleve
Hazis Vorfi.*

Në kovaçhanë hyj e dal gjithnjë.
Duart ustait posi qymyr i nxijnë
herë tymos ndonjë cigare me të,
herë trazoj thëngjihtë në kaminë.

Është e vërtetë. Ti ke hak, Kulluc¹⁾:
Ka gojë e flet... ka gjuhë prush' i kuç.

Vë mbi kamin' ustai dy-tri qysqi,
e skuqen hekurat dalëngadalë si plitka.

1) Kështu e thërrasin minatorët, në mënyrë miqësore, kovaçin Hazis Vorfi.